

MODULI 1

OFERTA E SHKOLLAVE PUBLIKE



RAPORT MONITORIMI

Mars 2024



AUTOR
MARSELA DELIJA

Tabela e përmbajtjes:

1. Hyrje	3
2. Përshkrimi i Programeve ekzistente / zhvilluara më parë	4
3. Vlerësimi i “ofertës” së shkollave publike	5
4. Sfidat dhe Problematikat.....	6
5. Përfundime dhe Rekomandime	7



1. Hyrje

Në kuadrin e ndryshimeve të shpejta sociale dhe ekonomike që ndodhin në shoqëri, arsimit luan një rol thelbësor në zhvillimin e aftësive, vlerave dhe njohurive të brezave të rinj. Përveç ofrimit të dijes bazë, shkollat janë gjithnjë e më shumë të angazhuara në zbatimin e programeve inovative që synojnë të përmirësojnë cilësinë e arsimit, të përgjigjen ndaj nevojave të ndryshme të nxënësve, dhe të kontribuojnë në forcimin e lidhjes mes institucioneve arsimore dhe komuniteteve përreth tyre. Duke marr parasysh edhe rritjen e numrit të regjistrimeve në arsimin bazë privat krahasuar me atë publik, në këtë raport kemi studiuar cilat janë kushtet në arsimin publik. Cfare ofrohet dhe cfarë i mungon nxënësve në bankat e shkollës.

Rritja e ndërveprimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe komunitetit çon në zhvillimin dhe zbatimin e shumë programeve, të cilat variojnë nga mbështetja akademike dhe sociale deri te aktivitetet jashtëkurrikulare dhe shërbimet mbështetëse. Programet si "Shkolla si Qendër Komunitare" dhe "Bëjmë Detyrat e Shtëpisë" janë vetëm disa shembuj që tregojnë angazhimin e shkollave për të tejkaluar rolin tradicional dhe për t'u bërë qendra të rëndësishme sociale dhe edukative.

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve dhe arritjeve, sfidat mbeten të mëdha. Infrastruktura shkollore, kushtet e mësimdhënies, si dhe aksesit i barabartë në arsim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevoja të veçanta, janë disa prej sfidave kryesore.

Qëllimi i këtij raporti është të analizojë efektivitetin e këtyre programeve, të vlerësojë infrastrukturën dhe shërbimet që ofrojnë shkollat publike, dhe të identifikojë sfidat dhe problematikat me të cilat përballen. Përmes një vlerësimi të gjithanshëm, raporti synon të ofrojë një pasqyrë të qartë të situatës aktuale, të nxjerrë në pah sukseset dhe sfidat, dhe të propozojë rekomandime për të përmirësuar gjendjen.



2. Përshkrimi i Programeve ekzistente / zhvilluara më parë

Në këtë pjesë do të fokusohemi në dy programe të veçanta që janë angazhimit të shkollave në përmirësimin e arsimit dhe integritit me komunitetin: "Shkolla si Qendër Komunitare" dhe "Bëjmë Detyrat e Shtëpisë". Dy programe që nisën me synimin që shkollat publike të zgjerojnë rolin e tyre tradicional arsimor për të përfshirë një gamë më të gjerë të shërbimeve që mbështesin jo vetëm nxënësit por edhe familjet e tyre dhe komunitetin më të gjerë. Angazhimi në këto programe do të ndihmonte në ndërtimin e një marrëdhënieje më të ngushtë midis nxënësve dhe komunitetit.

"Shkolla si Qendër Komunitare"

Objektivat: Programi "Shkolla si Qendër Komunitare" ka për qëllim të transformojë shkollat në qendra multifunktionale që shërbejnë jo vetëm si institucione arsimore por edhe si qendra për zhvillimin komunitar. Ky program synon të forcojë lidhjet midis shkollës dhe komunitetit, të ofrojë shërbime të ndryshme që adresojnë nevojat sociale, shëndetësore dhe kulturore të nxënësve dhe familjeve të tyre, dhe të nxisë përfshirjen e prindërve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit në aktivitetet e shkollës.

Zbatimi: Zbatimi i këtij programi ka përfshirë hapjen e shkollave jashtë orarit të mësimin për të organizuar aktivitete dhe programe të ndryshme, si seminare edukative për prindërit, kurse të ndryshme për të rriturit dhe fëmijët, si dhe qendrat e kujdesit të pas shkollës për nxënësit. Gjithashtu, shkollat kanë bashkëpunuar me organizata lokale dhe agjenci të qeverisjes lokale për të ofruar shërbime të tilla si kontrolla shëndetësore dhe këshillim. MAS raporton që ky program zbatohet vetëm në 522 shkolla.

"Bëjmë Detyrat e Shtëpisë"

Programi "Bëjmë Detyrat e Shtëpisë" është një iniciativë inovative që synon të aftësojë fëmijët në përparimin e tyre akademik, duke u ofruar një mjedis mbështetës dhe stimulues pas orarit shkollor. Ky projekt lejon nxënësit të kryejnë detyrat e tyre të shtëpisë dhe të përfundojnë mësimet brenda hapësirave të njohura dhe të sigurt të shkollës. Në veçanti, ai adreson nevojat e atyre nxënësve që përballen me vështirësi në kryerjen e detyrave në shtëpi dhe që rrezikojnë të mbeten pas bashkëmoshatarëve të tyre për shkak të kësaj.

Nisma u pilotua për herë të parë gjatë vitit shkollor aktual në 20 shkolla 9-vjeçare të vendosura në pesë nga Drejtoritë Arsimore Rajonale më të mëdha të Shqipërisë: Tiranë, Elbasan, Lezhë, Fier dhe Korçë. Përmes



kësaj përhapjeje, programi synon të vlerësojë efikasitetin dhe të përmatur përparimin e nxënësve në mënyrë që të mund të zgjerohet më pas në të gjithë vendin.¹ Momentalisht vetëm 188 shkolla zbatojnë këtë program.

3. Vlerësimi i “ofertës” së shkollave publike

Analiza e infrastrukturës shkollore dhe kushteve të mësimdhënies.

Shërbimet shtesë: ushqimi, transporti, ngrohja.

Në përpjekje për të kuptuar më mirë atë që shkollat publike në Shqipëri ofrojnë për nxënësit e tyre, do të shohim nga afër nëse shkollat kanë gjithçka që duhet për të bërë mësimin sa më mirë, duke përfshirë ndërtesat ku mësohet, si janë klasat, si dhe shërbime të tjera të rëndësishme si ushqimi, transporti dhe ngrohja. Po ashtu, do të hedhim një sy edhe te aktivitetet që bëjnë nxënësit pas mësimin, si sportet apo artet, të cilat ndihmojnë në rritjen e tyre jo vetëm si nxënës por edhe si individë që i shërbejnë shoqërisë dhe komunitetit.

Infrastruktura shkollore dhe kushtet e mësimdhënies, përfshijnë jo vetëm ndërtesat dhe klasat ku zhvillohet mësimi, por edhe laboratorët shkencorë, bibliotekat, dhe hapësirat për veprimtari fizike. Infrastruktura duhet të jetë e përshtatshme për të mbështetur një mjedis mësimor të pasur dhe të gjithanshëm që nxit përfshirjen dhe arritjen akademike të nxënësve.

Shërbimet shtesë, përveç mësimdhënies, shkollat duhet të ofrojnë shërbime si ushqimi i shëndetshëm, transporti i sigurt, dhe sisteme ngrohjeje. Këto shërbime janë jetike për të siguruar që të gjithë nxënësit kanë akses dhe mundësi të barabarta në edukim, pa marrë parasysh sfidat socio-ekonomike. Në disa shkolla në Shqipëri sistemi i ngrohjes qendrore nuk është funksional. Në rastet e uljes së temperaturave, Ministria e Arsimit ofron si zgjidhje shkurtimin e orëve mësimore ose anulimin e ditëve të mësimin.²

Sa i takon ushqimit, në shkollat publike në Shqipëri nuk ofrohet ushqim, duke krijuar kështu hapësira që nxënësit të ushqehen nga shitësit ambulantë në afërsi të shkollave, ku shpesh produktet janë të pakontrolluara.

Kjo situatë rrezikon shëndetin e nxënësve dhe çon në një varësi ndaj

¹ <https://www.kryeministria.al/newsroom/bejme-detyrat-e-shtepise-nisma/>

² <https://arsimi.gov.al/njofitim-mbi-situaten-e-ngrohjes-ne-shkolla/>



zgjedhjeve të ushqimit që mund të mos jenë të shëndetshme ose të sigurta. Implementimi i një programi kombëtar të ushqimit në shkolla, i cili ofron vaktet shëndetshme dhe të balancuara, do të ishte një hap mjaft i mirë për të siguruar që të gjithë nxënësit të kenë qasje në ushqim cilësor gjatë ditëve shkollore, duke përmirësuar kështu përqëndrimin dhe performancën akademike.

Çështja e transportit për në shkollë prek kryesisht fëmijët nga komunitetet romë dhe egjiptiane dhe fëmijët në zonat rurale. Transporti në shkolla është një nga barrierat për aksesin në arsim për çdo fëmijë, në shkollat publike ky mbetet një tjetër problem i pazgjidhur. Ku për fëmijët që jetojnë në largësi, ose në rrugë më terren të vështirë nuk ofrohen lehtësira.³ Kjo problematikë kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike nga autoritetet arsimore për të siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet pas për shkak të mungesës së transportit. Bashkëpunimi mes qeverisjes lokale dhe qendrore mund të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme, si transportin e subvencionuar për të lehtësuar arritjen në shkolla të fëmijëve nga zona të largëta.

Ndërkohë në shkollën fillore në Shupal, Tiranë, nëntor 2021, u bë publik lajmi sesi në këtë shkollë nuk kishte as kushtet baze, sic është tualeti për të kryer nevojat personale.⁴

Kjo adreson nevojën urgjente për të adresuar mungesën e infrastrukturës themelore në shkollat, e cila është esenciale për dinjitetin dhe mirëqenien e nxënësve. Është thelbësore që fonde të dedikuara të alokohen për riparimin dhe modernizimin e objekteve shkollore, duke garantuar që të gjithë nxënësit të kenë qasje në ambiente të sigurta dhe higjienike që mbështesin mësimdhënien dhe ritjen e tyre.

4. Sfidat dhe Problematikat

Klasat kolektive dhe shkollat me dy turne.

Klasë kolektive quhet klasa ku mësojnë së bashku nxënësit e dy a më shumë klasave të

arsimit fillor ose dy a më shumë klasave të arsimit të mesëm të ulët. Klasa kolektive mund të

³ <https://arsimi.gov.al/njoffim-mbi-situaten-e-ngrohjes-ne-shkolla/>

⁴ <https://faktoje.al/tirane-shkolla-me-teknologji-te-perparuar-vezhgimi-nuk-ka-banjo/>



emërtohet dhe “klasë e bashkuar”, pasi ajo është një bashkim nxënësish të grup-moshave të

ndryshme me diferencë nga një deri në pesë vjet në arsimin fillor, dhe nga një deri në katër

vjet në arsimin e mesëm të ulët.

Ndonëse në Kërkesën e dërguar për informacion, MAS raporton se numri i nënësve në klasat kolektive është ulur me 1.7%, por nuk raporton për numra. Klasat kolektive mbeten një nga sfidat më të mëdha të nxënësve në shkollat publike.

Mësimi më dy turne mbetet një tjetër problem i cilimund të sjellë sfida të ndryshme, siç janë zgjatja e orarit të punës për mësuesit dhe ndikimi në rutinat e përditshme të nxënësve dhe familjeve të tyre. Gjithashtu, ky sistem mund të ndikojë në sasinë dhe cilësinë e kohës që mësuesit mund t'u kushtojnë secilit nxënës, si dhe në mundësinë e organizimit të aktiviteteve jashtëkurrikulore. Edhe pas heqjes së masave kufizuese të pandemisë, vazhdon që të aplikohet mësimi me dy turne.⁵

5. Përfundime dhe Rekomandime

Përfundimet:

Infrastruktura e Pamjaftueshme: Shumica e shkollave publike kanë mungesë të infrastrukturës, duke penguar ofrimin e një mjedisi mësimor cilësor për nxënësit.

Mungesa e Shërbimeve Shtesë: Shkollat përballen me mungesën e shërbimeve si ushqimi, transporti dhe ngrohja, e cila prek në mënyrë disproporcionale nxënësit nga familjet me status socio-ekonomike të ulët.

Klasat e Mbingarkuara dhe Mësimi me Dy Turne: Sfidat me hapësirat e mësimdhënies dhe klasat e mbingarkuara, së bashku me mësimin në dy turne, ulin cilësinë e edukimit.

Mungesa e Përfshirjes së Komunitetit dhe Prindërve: Pavarësisht nismave të disa programeve, ende ka një mungesë të theksuar të përfshirjes së prindërve dhe komunitetit në proceset edukative dhe vendimmarrje.

⁵ <https://faktoje.al/18451-2/>



Rekomandimet:

- Qeveria duhet të risë investimet në përmirësimin e infrastrukturës shkollore për të siguruar mjedise mësimore të sigurta dhe të përshtatshme.
- Është i domosdoshme zgjerimi i ofertës së shërbimeve si ushqimi, transporti, dhe ngrohja për të gjithë nxënësit.
- Nevojiten strategji për të reduktuar mbingarkesën e klasave dhe për të eliminuar nevojën për mësimdhënie me dy turne.
- Duhet të ndërmerren hapa konkretë për të fuqizuar rolin dhe përfshirjen e prindërve dhe komunitetit në proceset edukative dhe vendimmarrje në shkolla.



#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

EMPOWER PEOPLE. CHANGE THE WORLD.

www.qeverisja.qq.com.al